EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6140
E premte, 16 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Shoqëria civile u bën thirrje deputetëve ta votojnë ligjin për financimin e subjekteve politike

FAQE 6




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MIROSLLAV LAJÇAK KA PËRFUNDUAR VIZITËN TREDITORE NË KOSOVË FAQE 4-5

# LAJÇAKU: KOSOVA TË JETË E GATSHME PËR KOMPROMIS, ASOCIACIONI ËSHTË OBLIGIM



I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i ka bërë thirrje lidershipit të Kosovës që të jetë i gatshëm për kompromis në dialogun me Serbinë. Në përfundim të vizitës së tij në Prishtinë, ai ka thënë se asociacioni i komunave me shumicë serbe është obligim të cilin duhet të zbatojë Kosova. Sipas tij, pa asociacion nuk mund të ketë normalizim në mes të dy vendeve. Lajçaku ka deklaruar se liderët politikë ia kanë konfirmuar se Kosova do t'i respektojë të gjitha angazhimet e saj, përfshirë edhe krijimin e asociacionit

## QUNI: PROCESI I VLERËSIMIT TË USHTARËVE TË RINJ DO TË BËHET SIPAS STANDARDEVE TË USHTRIVE BASHKËKOHORE



Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, kanë parë nga afër procesin e testimit fizik të kandidatëve të cilët synojë të jenë pjesë e ushtrisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Quni është zotuar se procesi i testimit dhe vlerësimit të ushtarëve të rinj do të bëhet sipas standardeve më të larta të ushtrive bashkëkohore

## ASNJË I VDEKUR DHE 77 RASTE TË REJA ME COVID NË 24 ORËT E FUNDIT

FAQE 7




## OPINION

### A DO TË KETË ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME NË KOSOVË? DEFINITIVISHT JO!

F. 11

Shkruan:
Behxhet Sh. SHALA BAJGORA



## AKTUALE



### LIMAJ: HUNGARIA VAZHDIMISHT E KA MBËSHTETUR ÇËSHTJEN E LIBERALIZMIT TË VIZAVE F. 7

### MASH-i PËRFITON 35 LLAPTOPË DONACION NGA KFOR-i ITALIAN

F. 6

### BALAJ-HALIMAJ: DO TË ZBARDHEN RASTET E DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS F. 7

## EKONOMI



### VESELI: FERMERËT KANË NEVOJË PËR PËRKRAHJE, TË KONSUMOHEN PRODHIMET VENDORE F. 8

### PREZANTOHET MASTER PLANI I UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE

F. 9

### EKZEKUTOHEN EDHE MBI 16 MILIONË EURO PËR BIZNESET F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Qeveria shqiptare do t'i ndajë kostot për të punësuarit edhe në bizneset e vogla

**Tiranë, 15 tetor** - Qeveria e Shqipërisë ka vendosur ta zgjerojë programin e nxitjes së punësimit, ku subvencionon pagat dhe një pjesë të sigurimeve shoqërore për të papunët që rihyjnë në tregun e punës jo vetëm për kompanitë e mëdha, por edhe për bizneset e vogla dhe të vetëpunësuarit. Tashmë edhe këto ndërmarrje të vogla kanë të drejtë të aplikojnë në këtë program për të marrë në punë individë që nuk janë të punësuar duke ndarë një pjesë të kostove me qeverinë. E gjithë skema do të funksionojë përmes tri programeve. I pari ka fokusin te të rinjtë që janë të papunë, ku shteti merr përsipër t'i paguajë të gjithë sigurimet shoqërore për 1 vit dhe 4 muaj deri në 1 vit pagë minimale. Dy programet e tjera kanë fokusin në aftësimin profesional. Për të gjithë procesin e punës dhe marrjes së përvojës nga punëmarrësi, shteti paguan sigurime shoqërore dhe pagën minimale, ndërsa te intershipet jepet edhe pagesë për mentorin. Skema ka si qëllim gjallërimin e tregut të punës dhe zbutjen e efekteve që ka lënë pandemia Covid-19. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit në 11.9 për qind në fund të qershorit, ndërsa 50 mijë individë humbën vendin e punës.



# Meta: Grupet kriminale marrin përsipër kontrollin elektoral të qarqeve



**Tiranë, 15 tetor** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se grupet kriminale marrin përsipër kontrollin elektoral të qarqeve të caktuara. Ai ka thënë se shpërthimi i kanabisit në vit zgjedhor është traditë që përdoret si mjet përfitimi për grupet kriminale. "Shpërthimi i kanabisit në vit zgjedhor është traditë e njohur tashmë për t'u përdorur si mjet përfitimi për grupet kriminale që marrin përsipër kontrollin elektoral të qarqeve të caktuara, por edhe si mjet shantazhi ndaj shumë hallexhinjve që në mungesë të mbështetjes shtetërore për aktivitetet bujqësore, blegtorale, të agrobiznesit dhe agroturizmit janë të detyruar të bëhen punëtorë të këtyre grupeve kriminale. Bosët e vërtetë kurrë nuk preken, por shpesh për të prodhuar statistika fiktive, arrestohen gra dhe burra të moshuar si grup i strukturuar kriminal", ka thënë Meta.

# Balla takon kryeministrin e Maqedonisë së Veriut

**Shkup, 15 tetor** - Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Taulant Balla, ka zhvilluar një takim në Shkup me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Në këtë takim ata kanë ndarë vlerësimin e përbashkët se raportet në mes të dy shteteve janë shembull për rajonin. "Gjatë takimit me kryeministrin Zaev ndamë vlerësimin e përbashkët se raportet miqësore midis kryeministrave Zaev dhe Rama janë një faktor bazë dhe i rëndësishëm mbi të cilin po zhvillohen marrëdhëniet e mira fqinjësore në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy kryeministrave Rama dhe Zaev janë një shembull i mirë në rajon dhe një tregues se 'atje ku ka vullnet politik, ka respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim të suksesshëm'. Të dy vendet tona besojnë dhe promovojnë të njëjtat vlera evropiane", ka thënë Balla.



# Mbajtja e maskës, Rama: Po të ishte kot, s'do e vendoste gjithë bota

Policia kontrollin do ta nisë nga Parlamenti i Shqipërisë. Kështu është shprehur kryeministri Edi Rama, teksa ka prezantuar platformën "Deputeti që duam", në kohën kur në Shqipëri ka hyrë në fuqi rregulli i ri anti-Covid, ai i mbajtjes së maskës jo vetëm brenda ambienteve të mbyllura.



Ai ka thënë se po të ishte kot, maskën s'do ta vendoste e gjithë bota. "S'duhet ta vëmë këtë maskën me idenë se do të marrim gjobë. I kam kërkuar Policisë së Shtetit që të jetë e vëmendshme dhe vëmendjen ta ketë fillojë Parlamenti i Shqipërisë, nga institucionet qendrore. Teorikisht duhet të jetë e vështirë. Nuk është e mundur që policia të më ndalojë makinën mua e të më shoh nëse e kam mbajtur apo jo maskën. Unë sot e kam mbajtur maskën. Gjermania sot mesa pashë e vuri në mjediset publike. Para disa ditësh s'pashë maskë asgjëkundi jashtë. Ndërkohë që brenda po. Në Austri as brenda as jashtë. Të gjithë po e mbajnë tani. Se pashë nëpër media, qytetarët që thoshin që; "kemi frikë nga gjoba se maska kot është". Po të ishte kot nuk do e vinte gjithë bota, se mirë diktatura gjakatare në Shqipëri po imponon maskën që t'u mbyllë gojën shpirtrave të lirë që të mos flasin", është shprehur Rama, duke paralajmëruar gjoba për ata që nuk bartin maskë. "Kjo është një betejë jashtëzakonisht e komplikuar, një luftë pavarësisht se disave nuk u pëlqen përdorim i këtij termi, është luftë e gjatë, nervash dhe për hir të vërtetës sjellja e shumicës së shqiptarëve ka qenë shumë pozitive, sot mbresëlënëse, mbajtja e maskave, është 99 për qind me një sy të parë, ndërkohë që gjobat që janë vënë janë amnistuar në një moment të caktuar për të dhënë edhe një mesazh tjetër që këtu nuk është çështja e frikës. Është çështja ta kuptojmë mirë që duhet të gjithë të kontribuojmë, nga ana tjetër për hir të vërtetës në faljen që bëmë vlerësuam edhe një fakt tjetër, ata të cilët nuk kishin paguar ende apo ende kishin makina të bllokuara, prej shkeljes së rregullave meritonin një mirëkuptim pasi sidoqoftë një periudhë jo e shkurtër kaloi dhe për sa u përket gjobave tani sigurisht që s'është dëshira të vëmë gjoba. Ju e dini që unë me gjobën kam një raport shumë strikt, asnjëherë se kuptoj që thonë se gjobat janë të larta, për mua duhet të jenë shumë më të larta, s'është taksë, është ndëshkim për diçka që ti ke në dorë të mos e bësh", ka deklaruar Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 59 të shëruar dhe 77 raste të reja me Covid-19

# Asnjë i vdekur dhe 77 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit




Gjatë 24 orëve të fundit nuk është raportuar asnjë rast i personit të vdekur nga Covidi. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 77 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 59 persona. “Numri total i rasteve pozitive është 16 502 raste nga 77 272 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 650 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 59 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 519 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 333”, ka njoftuar IKShPK-ja

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 15 tetor** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 77 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 59 persona. Ky institut, ka treguar se gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Covid-19. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët private me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 649 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 77 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 16 502 raste nga 77 272 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 650 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 59 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 519 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 333”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar rastet e reja sipas secilës komunë. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 46 raste, komuna Fushë Kosovë 7 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Podujevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Lipjan dhe Shtime. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!”, ka njoftuar IKShPK-ja.

## UNDP-ja dhe katër shtete evropiane ndihmojnë Kosovën me 12 mijë teste për Covid

Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, ajo e Zvicrës, e Norvegjisë dhe e Austrisë, në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, vazhdojnë të ndihmojnë Kosovën me pajisje për testim të Covid-19. Në një njoftim nga UNDP-ja është bërë me dije se në donacionin e fundit, që i është dorëzuar Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe Ministrisë së Shëndetësisë, janë 24 pako të PCR Univerzal/Viral për grumbullimin e mostrave që përmbajnë 12 000 copë teste. “Pandemia ka zhvendosur fokusin e UNDP-së dhe partnerëve të saj afatgjatë për të luftuar Covid-19. Që nga shpërthimi i pandemisë, me kontributin bujar të partnerëve zhvillimorë, ne kemi pasur mundësinë që në vazhdimësi të mbështesim institucionet e Kosovës për të tejkaluar këtë sfidë të fundit globale. Ne kemi punuar pa ndërprerë për të reduktuar dhe parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë, duke qëndruar së bashku me popullin e Kosovës në këto kohë të vështira. Ky donacion i pajisjeve të testimit rikonfirmon partneritetin tonë të përbashkët, të palëkundshëm dhe të vazhdueshëm me institucionet shëndetësore, besimin se ne jemi më të fuqishëm së bashku në luftën kundër Covid-19 dhe është një tjetër shembull i shkëlqyeshëm i një përgjigje efektive ndaj krizës”, ka njoftuar UNDP-ja. UNDP-ja në Kosovë, si agjenci kyçe e ekipit të OKB-së në Kosovë (UNKT), është duke mbështetur qytetarët dhe institucionet e Kosovës që të përgatiten, t’i përgjigjen dhe ta rimarrin veten nga pandemia, duke u përqendruar veçanërisht në më të prekurit.

## Zemaj vlerëson lart punën e policisë në luftimin e pandemisë



Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vlerësuar lart punën e Policisë së Kosovës, sidomos gjatë kohës e pandemisë. Ai ka thënë se policia gjatë gjithë kësaj kohe ka qenë në nivel të detyrës. “Policia edhe gjatë pandemisë është në krye të detyrës, me kapacitet të plotë. Përkushtimi për zbatim të ligjit u konfirmua edhe me numrin e të infektuarve dhe rastet tragjike nga Covid 19, brenda radhëve të policisë sonë. Për fat të keq, Covid-19 ka prekur edhe pjesëtarë e PK-së, madje kemi pasur edhe jetë të humbura të policëve si pasojë e infeksionit me Covid, andaj u shprehi ngushëllimet më të sinqerta familjeve, ndërsa të infektuarve shërim të shpejtë”, ka thënë Zemaj pas vizitës që i ka bërë policisë në Pejë.



Mirosllav Lajçaku ka përfunduar vizitën treditore në Kosovë

# LAJÇAKU: KOSOVA TË JETË E GATSHME PËR KOMPROMIS, ASOCIACIONI ËSHTË OBLIGIM

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, i ka bërë thirrje lidershipit të Kosovës që të jetë i gatshëm për kompromis në dialogun me Serbinë. Në përfundim të vizitës së tij në Prishtinë, ai ka thënë se asociacioni i komunave me shumicë serbe është një obligim të cilin duhet ta zbatojë Kosova. Sipas tij, pa asociacion nuk mund të ketë normalizim në mes të dy vendeve. Lajçaku ka deklaruar se liderët politikë ia kanë konfirmuar se Kosova do t'i respektojë të gjitha angazhimet e saj, përfshirë edhe krijimin e asociacionit

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 15 tetor** - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka bërë me dije se ky proces është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhmen evropiane të Kosovës. Në përfundim të vizitës së tij në Prishtinë, ai i ka ftuar liderët politikë të Kosovës që të jenë të gatshëm për kompromis në këtë proces. "Dialogu është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhmen evropiane të Kosovës. Dialogu i ofron Kosovës një mundësi për të diskutuar për të gjitha çështjet e pazgjidhura me Beogradin. Dialogu duhet t'i mbyllë të gjitha çështjet e hapura, por në të njëjtën kohë duhet të jetë e qartë se çdo marrëveshje mund të jetë vetëm rezultat i një kompromisi. Unë u bëra thirrje bashkëbiseduesve që të jenë të gatshëm për kompromis", ka deklaruar Lajçaku.

Në konferencën për media, zyrtari i lartë evropian, i cili lehtëson procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nuk ka treguar se çka nënkupton ai me normalizim në mes të dy vendeve. "Mua nuk më takon që ta përkufizoj se çfarë nënkupton normalizimi. Ana e Kosovës e ka bërë shumë të qartë se cili është interpretimi juaj për normalizimin dhe ana e Beogradit është shumë e qartë se çka nënkupton me normalizim dhe ne jemi këtu që të ndihmojmë që të gjejmë një normalizim. Unë jam këtu vetëm ta lehtësoj marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë. Janë të dyja palët që duhet të pajtohen", ka thënë ai, duke shtuar se nuk do të ketë normalizim pa asociacion të komunave me shumicë serbe. "Nëse nuk ka vullnet për marrëveshje nuk do të ketë marrëveshje. Nuk do të ketë normalizim të marrëdhënieve pa asociacion", ka thënë Lajçaku.

Duke folur për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, ai ka thënë se Kosova e ka marrë obligim këtë çështje, të cilën duhet ta zbatojë. Sipas tij, institucionet e Kosovës duhet ta fillojnë diskutimin për statutin e asociacionit si dhe t'i përfundojnë të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme për këtë proces. "Gjëja tjetër është të diskutojmë mbi statutin dhe kjo është ajo që ne presim.



Asociacioni është pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Marrëveshja do të fillojë të zbatohet pas nënshkrimit. Pra, kjo do të thotë se zbatimi i marrëveshjes së asociacionit, do ta pasojë nënshkrimin e marrëveshjes. Por, detajet e asociacionit duhet të pajtohen si pjesë e negociatave, sepse nuk duhet të mungojë qartësia e ndonjë çështjeje në momentin e nënshkrimit", ka deklaruar Lajçaku. Sipas tij, themelimi i këtij mekanizimi duhet të bëhet sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese. "Marrëveshja për asociacionin është arritur në Bruksel në vitin 2013 dhe pastaj më 2015, por nuk është implementuar. Është opinion i Kushtetutës. Duhet themeluar në pajtueshmëri me Gjykatën Kushtetuese. Duhet të diskutohet statuti në hapin e radhës", ka thënë ai.

Zyrtari i BE-së ka treguar se rezultati më i rëndësishëm i vizitës së tij në Kosovë është se gjatë takimeve është konfirmuar se Kosova do t'i respektojë të gjitha angazhimet e saj, përfshirë atë për krijimin e asociacionit. "Jam shumë i lumtur të them se në të gjitha takimet, partnerët e mi shprehën mbështetjen e tyre për dialogun. Ata shprehën mirëkuptimin se dialogu është i mirë dhe i rëndësishëm për Kosovën dhe konfirmuan se Kosova do t'u dalë zot të gjitha zotimeve të tyre - përfshirë edhe atë për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe", ka deklaruar Lajçaku.

Në adresimin për media, i dërguari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi ka folur edhe për rrjedhën e procesit pas rifillimit. "Filluam procesin duke diskutuar dy çështje të rëndësishme. E para çështja e të zhdukurve dhe të zhvendosurve, temë e rëndësishme, sepse kjo përfshinë familjarët e të cilëve po mundohen ta identifikojnë vendin e të dashurve të tyre, çështje e rëndësishme për pajtimin/ çështjet ekonomike shumë e rëndësishme sepse simbolizon bashkëpunimin rajonal dhe kemi bërë progres të plotë në këtë çështje dhe na ka dhënë mundësi të adresojmë Pakon e radhës të çështjeve që janë sensibile, komplekse e të rënda", është shprehur Lajçaku.

Ai ka falënderuar edhe kryeministri Avdullah Hoti. "Falënderoj kryeministrin Hoti dhe kryenegociatorin Skender Hyseni. Hoti ka treguar lidership të vërtetë në rifillim të dialogut në rrethana të vështira. Ai kritikohet shpesh rënd këtu, por ai është marrë me tema të mëdha e përkushtim të vërtetë dhe shtetet e BE-së e kanë vërejtur dhe e çmojnë këtë. Nuk ka çështje të lehta dhe ne pajtohemi t'i diskutojmë çështjet për të zgjidhur ato", ka deklaruar Lajçaku.

### Kosova insiston në njohjen reciproke

Gjatë vizitës në Kosovë përfaqësuesi special i BE-së i ka takuar të gjithë liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës. Këta të fundit, pas takimit me të, kanë bërë me dije se Kosova në këtë dialog do të diskutojë vetëm për njohje reciproke.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar se formimi i asociacionit nuk do të bëhet pa arritjen e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi. Kjo marrëveshje, sipas Hotit, duhet të përfundojë me njohje të dyanshme. "Asgjë nuk fillon të zbatohet derisa nuk përmbyllet marrëveshja përfundimtare me njohje reciproke e ratifikuar në Kuvendin e Kosovës", ka deklaruar Hoti pas takimit me zyrtarin e BE-së.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas takimit me Lajçakun, ka kërkuar që në tryezën e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë të diskutohet për njohje reciproke. "Të hidhet në tryezë mundësia e diskutimit për njohjen reciproke dhe kjo duhet të jetë pika e parë e marrëveshjes pastaj çështjet e tjera vijnë më lehtë dhe jo të vazhdohet me çështje teknike qe i kemi diskutuar tash e dhjetë vjet në Bruksel", ka deklaruar Thaçi.

Përveç liderëve institucionalë dhe partiakë, Lajçak ka takuar edhe ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Kosovë në Prishtinë, Philip Kosnett, me të cilin ka diskutuar për "interesat e përbashkëta" në dialogun Kosovë - Serbi. "Marrëveshjet e Uashingtonit e plotësojnë këtë proces të udhëhequr nga BE-ja. Do të vazhdojmë të punojmë së bashku për t'i arritur qëllimet e përbashkëta: normalizimin dhe njohjen e ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Kosnett në "Twitter".

Pas Prishtinës, Lajçaku është nisur për vizitë në Beograd. Gjatë rrugës për në Serbi, ai është ndalur për vizitë në pikën e Merdarit. Zyrtari i BE-së në Serbi pritet të takohet me presidentin serb Aleksandër Vuçiq.

Marrëveshja e Brukselit është dokumenti i parë mbi normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës. Kjo marrëveshje është nënshkruar në Bruksel më 2013. Një nga pikat kryesore ishte formimi i asociacioni të komunave me shumicë serbe. Në vitin 2015, Serbia dhe Kosova arritën edhe një marrëveshje shtesë për parimet e themelimit e këtij asociacioni. Por, kjo marrëveshje përfundoi në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e cila ka konstatuar se në 23 pika të marrëveshjes, parimet nuk janë në harmoni me Kushtetutën e Kosovës, edhe pse ka thënë se ato mund të harmonizohen me një akt ligjor të Qeverisë së Kosovës.

# Profesori amerikan: Marrëveshja e Uashingtonit nuk ka sjellë relaksim të raporteve Kosovë - Serbi

**Prishtinë, 15 tetor** - Profesori në Universitetin "John Hopkins", Edward P. Joseph, ka folur për marrëdhëniet dhe dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se deri tani nuk është vërejtur ndonjë ndryshim në raportet e Prishtinës dhe Beogradit pas nënshkrimit të marrëveshjes ekonomike. "Së pari, megjithëse na u premtua që përqendrimi në ekonomi do ta 'relaksonte atmosferën', në të vërtetë ajo u bë toksike. Ministri serb i Mbrojtjes përdori një fjalë jashtëzakonisht fyese për shqiptarët në komunikimin zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila provokoi dhe pati reagime nga Prishtina dhe Tirana. Ministri serb i Punëve të Jashtme tha: 'Çfarë do të bëjmë me serbët që tregojnë se ku janë varrosur shqiptarët në të gjithë Serbinë?' Unë ju pyes, a tingëllon kjo si një atmosferë e relaksuar që na u premtua pas 'përparimit historik' në Uashington?", ka deklaruar ai.

Ai ka vlerësuar se ndikimet e deklaratave të zyrtarëve serbë shkojnë përtej Kosovës. "Implikimet shkojnë përtej Kosovës, në Bosnjë. Atje u shfaq në një letër nga kreu i organizatës boshnjake që merret me Srebrenicën dhe Zepën drejtuar zyrtarëve të gjykatës së Hagës në të cilën thuhej: Ivica Daçiq vendos në shënjestër kokat e të gjithë atyre në Serbi të cilët do të donin të flisnin për ekzistencën e varrezave masive të shqiptarëve në territorin e Serbisë", ka deklaruar ai.



Sa i përket asociacionit të komunave serbe dhe deklaratave të kryeministrit Avdullah Hoti, se nuk dëshiron që në marrëveshjen përfundimtare të jetë ajo e përfshirë, Joseph ka deklaruar se në çdo negociatë është thelbësore që të shmanget dështimi. "Kjo është një çështje më shumë për organizatorët e dialogut sesa për secilën palë të ekipeve. Në çdo negociatë është thelbësore të shmanget dështimi, për shembull, kur njëra palë këmbëngul për një çështje dhe të tjetra refuzon. Kjo arrihet nëse ka një rend të diskutimit të problemeve", ka deklaruar ai.

Ai ka folur edhe për deklaratat e Joseph Borrellit i cili ka thënë se shumë shpejt do të përfundojë marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi, duke thënë se nëse kjo do të ndodhë është e mrekullueshme. "Do të ishte e mrekullueshme nëse kjo do të ishte e vërtetë, por çka e tregon se kjo do të ndodhë? Le ta krahasojmë këtë situatë me negociatat e fundit midis Greqisë dhe Maqedonisë Veriore. Ne kemi parë që të dyja palët ndërmorën hapa qëllimisht dhe me përgjegjësi për ta lehtësuar retorikën. Kryeministri Zaev ndryshoi emrin e autostradës dhe aeroportit pikërisht për të ndihmuar në negociatat, të cilat e detyruan Greqinë ta njohë e identitetin e Maqedonisë së Veriut dhe gjuhën maqedonase", është shprehur ai në një intervistë për "Kosovonline".

# Selimi prezanton Projektligjin për avokaturën shtetërore



PRISHTINË, 15 TETOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka prezantuar të enjten Projektligjin për avokaturën shtetërore. Në një konferencë për media ai ka thënë se ky projektligj është në fazën finale dhe së shpejti do të dërgohet në qeveri. "Po e prezantojmë projektligjin për avokaturën shtetërore, i cili është në fazën finale dhe shpejt do dërgohet në qeveri. Tri çështjet kryesore që lidhen me ligjin, e para ka të bëjë me atë se për herë të parë është vënë në plan të shtetit avokatura. Një çështje tjetër që parashihet me këtë ligj është obligimi për denoncimin e keqpërdorimeve. Me këtë normë do ta përçojmë mesazhin që çdo keqpërdorim do ta ketë edhe një mekanizëm shtesë. Po ashtu, parashihet vlerësimi i riskut të draft-kontratës, ku përmes kësaj e kemi marrë për obligim që t'i analizojmë draftkontratat fillimisht, para se të lidhet kontrata", ka thënë Selimi.

Ndërsa avokati i shtetit, Sami Istrefi, ka deklaruar se ka qenë e domosdoshme që Kosova ta ketë një draftligj të tillë. "Do të rregullohet edhe një sektor i veçantë i arbitrazhit, sepse kohën e fundit është goditur Kosova në procesin e arbitrazhit. Me këtë projektligj do të plotësohet vakuumi institucional që ka qenë për vite të tëra", ka theksuar ai.

# Shoqëria civile u bën thirrje deputetëve ta votojnë ligjin për financimin e subjekteve politike

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Kuvendi i Kosovës sot (e premte) pritet ta shqyrtojë në lexim të parë projektligjin lidhur me financimin e subjekteve politike. Shoqëria civile ka vlerësuar se versioni i projektligjit që është sjellë në Kuvend përbën një hap të madh për avancimin e transparencës dhe llogaridhënies financiare të subjekteve politike karshi publikut. "Miratimi i këtij projektligji, që reflekton edhe opinionin e Komisionit të Venedikut, ka qenë kërkesë e vazhdueshme e shoqërisë civile dhe e faktorit ndërkombëtar. Si entitete që synojnë të qeverisin me qytetarët dhe vendin, subjektet politike duhet të demonstrojnë shembull të mirë të vetëqeverisjes, duke garantuar në radhë të parë që, financimi dhe shpenzimet e tyre bazohen në parimet e transparencës dhe llogaridhënies", është thënë në një deklaratë të përbashkët të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, shoqëria civile u ka bërë thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos vonojnë votimin e këtij projektligji. "Miratimi në lexim të parë do t'i hapë rrugë krijimit të grupit punues, puna e të cilit kërkojmë që të jetë e hapur dhe transparente, si dhe ta garantojë përfshirjen e shoqërisë civile", është thënë në këtë deklaratë.

Kjo deklaratë është nënshkruar nga: Demokraci Plus (D+), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), Lëvizja FOL, Organizata Çohu! Dhe Westminster Foundation for Democracy (WFD).




# MASh-i përfiton 35 llaptopë donacion nga KFOR-i italian




PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh) ka pranuar nga KFOR-i 35 kompjuterë llaptopë për zhvillimin e mësimit në distancë për shkollat në Kosovë. Me këtë rast, ministri Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka deklaruar se ky donacion do t'i ndihmojë nxënësit në mësimin online. Ndërsa komandanti i KFOR-it, Michele Risi, ka deklaruar se ndihen krenarë për këtë ndihmë. Ai ka thënë se falë donacionit të financuar nga arsimtarët italianë të Mbrojtjes, do të jenë në gjendje nxënësit të regjistrojnë video-mësime dhe të ofrojnë mësim online, në mënyrë që ta frenojnë përhapjen e Covid-19.

Projekti është zbatuar nga ekipi i bashkëpunimit civil-ushtarak i ushtrisë italiane së bashku me pjesëtarët e artilerisë së regjimentit të 5-të të komanduar nga koloneli Gianluca Figus, të vendosur në Pejë.

## Limaj: Hungaria vazhdimisht e ka mbështetur çështjen e liberalizmit të vizave

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, me të cilin ka biseduar për situatën në vend në këtë kohë pandemie, liberalizimin e vizave, rritjen e bashkëpunimit në ekonomi, edukim, siguri etj.
Kryetari Limaj ka theksuar se Hungaria është një nga vendet që vazhdimisht e kanë mbështetur çështjen e liberalizimit të vizave, ku Kosova tashmë i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim dhe është e padrejtë që qytetarët tanë të mbesin edhe më tej të izoluar.
Ndërsa ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze, është shprehur se qeveria hungareze është e gatshme ta mbështesë me gjithë ekspertizën e saj shtetin e Kosovës në rrugën e saj të integrimeve euroatlantike.



# Quni: Procesi i vlerësimit të ushtarëve të rinj do të bëhet sipas standardeve të ushtrive bashkëkohore

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, kanë parë nga afër procesin e testimit fizik të kandidatëve të cilët synojnë të jenë pjesë e ushtrisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Quni është zotuar se procesi i testimit dhe vlerësimit të ushtarëve të rinj do të bëhet sipas standardeve më të larta të ushtrive bashkëkohore



"Epoka e re"

PRISHTINË, 15 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe atasheu i Mbrojtjes së ShBA-së, kolonel Stephen Rose, kanë realizuar një vizitë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së në Ferizaj. Qëllimi i vizitës ishte njoftimi nga afër me procesin e testimit fizik të kandidatëve për përzgjedhjen e ushtarëve aktivë të FSK-së, i cili është duke u realizuar në kuadër të procesit rekrutues për vitin 2020. Paraprakisht, ministri Quni me delegacionin e tij ka vizituar shtabin e përgjithshëm të FSK-së, ku nga ana e shefit të Departamentit të Personelit, kolonel Ilir Shyti, është njoftuar me procesin e përgjithshëm të rekrutimit, aktivitetet, të arriturat e deritashme dhe procedurat e përzgjedhjes në proces e sipër.
Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ministri Quni dhe gjeneral Rama janë pritur nga komandantja, gjeneralbrigade Irfete Spahiu, e cila i ka njoftuar ata me aktivitetet e njësisë në përgjithësi me fokus në angazhimin e pjesëtarëve të saj dhe mbështetjen e përgjithshme të ekipit vlerësues në realizimin sa më të suksesshëm të testimit fizik të kandidatëve për ushtarë aktiv.
Në fjalën e tij, ministri Quni ka vlerësuar lart angazhimin e Departamentit të Personelit të ShPFSK-së, ekipit vlerësues të instruktorëve dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, edhe pse në kushte të kufizimeve dhe masave anti-Covid, për angazhimet dhe të arriturat e deritashme, duke shprehur besimin e realizimit të suksesshëm të këtij procesi, me vlerësimin e kandidatëve më të suksesshëm për garim në fazat e tjera të testimit me kurorëzim të procesit duke përzgjedhur kontingjentin e ushtarëve të rinj të synuar për vitin 2020.
Nga ana e tij, gjenerallejtënant Rama ka shprehur mirënjohjen për angazhimin e deritashëm dhe ka kërkuar nga përgjegjësit të vazhdojnë me respektimin e plotë të procedurave, kritereve dhe standardeve më të larta të testimit, kompatibile me ato të vendeve më të avancuara të NATO-s.
Përshtypjet e tij gjatë vizitës i ka shprehur edhe kolonel Rose, i cili ka çmuar lart përkushtimin e të gjithëve për realizimin sa më të suksesshëm të testimit edhe pse nën masat kufizuese anti-Covid.
Në vazhdim, ministri Quni dhe gjenerallejtënant Rama, me delegacionin shoqërues, kanë vizituar stacionet e testimit fizik, ku nga afër kanë parë ekzekutimin e disiplinave nga ana e kandidatëve të sotëm si dhe procedimin e vlerësimit të tyre nga ana e personelit të autorizuar.
"Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja iu shërbejnë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ju mirëpresin juve për shërbim në FSK, pa dallim nga përkatësia juaj etnike" ka thënë Quni në adresimin e tij para kandidatëve të pranishëm. Kurse gjenerallejtënant Rama, kandidatët e pranishëm i ka inkurajuar për rezultate sa më të larta në testime, duke ua rikujtuar nderin, privilegjin, por edhe përgjegjësinë e lartë e të qenit ushtarë e ushtare në mbrojtje të vendit e qytetarëve tanë. Procesi i rekrutimit të ushtarëve në FSK për vitin 2020 ka filluar më 10 gusht me fazën e aplikimit duke vazhduar me shqyrtimin fillestar të aplikacioneve. Nga data 28 shtator është duke u zhvilluar procesi i testimit fizik për të vazhduar me testet dhe procedurat e tjera. Ky proces është duke u monitoruar edhe nga ekipi i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) që dëshmon transparencën dhe llogaridhënien e plotë institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si institucionet me besueshmërinë më të lartë qytetare për vite me radhë.

## Balaj-Halimaj: Do të zbardhen rastet e dhunës seksuale gjatë luftës

DRENAS, 15 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka vizituar të enjten Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas. Gjatë kësaj vizite ajo ka thënë se si shoqëri ndihen keq që ende ata që kanë kryer këto krime janë në liri. Balaj-Halimaj ka theksuar se këto raste do të zgjidhen. "Emocion i veçantë me u taku me këto gra dhe ne si shoqëri ndihemi keq si shoqëri derisa këta kriminelë janë në liri. Kjo qendër është marrë ekskluzivisht me dhunimin e grave dhe unë këtu kam premtuar që ka me pas ndriçim të këtyre rasteve. Dhuna seksuale në Kosovë është në kategorinë e gjenocidit ku kemi thuajse 20 mijë gra të dhunuara", ka thënë ajo.
Ndërsa drejtoresha e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, Kadire Tahiraj, ka kërkuar që të shqyrtohet statusi i njohjes së viktimave të dhunuara. "Njohja e statusit të viktimave u zotua se do të shqyrtohet", ka thënë Tahiraj.



## Ekzekutohen edhe mbi 16 milionë euro për bizneset



PRISHTINË, 15 TETOR - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) ka bërë ekzekutimin e pjesës së dytë të mjeteve në mbështetje financiare për bizneset. Shuma e ekzekutuar kap vlerën e 16 424 476 milionë eurove për gjithsej 11 244 biznese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara me Programin për rimëkëmbje ekonomike tjera. "Bëjmë me dije se dy ditë më parë MEA ka bërë pagesën e parë në vlerë prej 37 710 730 milionë eurosh subvencione për 15 474 biznese. Theksojmë se kjo shumë ndahet në zbatim të Programit për rimëkëmbje ekonomike i miratuar ditë më parë nga Qeveria e Republikës së Kosovës ku vlera totale e këtij programi është 60 milionë euro. Pjesa e mbetur dhe bizneset e tjera të cilat akoma nuk kanë pranuar mjetet do të paguhen në ditët në vijim ku e ritheksojmë se do të përfitojnë të gjitha bizneset të cilat kanë aplikuar sipas kritereve të parapara", ka njoftuar MEA-ja.

# Buxheti, sfida e ardhshme e Qeverisë së Kosovës

**Njohës të çështjeve ekonomike dhe monitorues të punës së Kuvendit kanë vlerësuar se sfida e ardhshme e Qeverisë së Kosovës do të jetë miratimi i buxhetit për vitin 2021. Ata kanë theksuar se për shkak vendimmarrjes së "brishtë" në Kuvend, buxheti rrezikon të mos votohet në afatet e caktuara ligjore**



PRISHTINË, 15 TETOR - Sfida e ardhshme për Qeverinë e Kosovës vlerësohet të jetë miratimi nga deputetët i Projektligjit për buxhetin e vitit 2021, i cili në Kuvend duhet të paraqitet pas muajit tetor, ka thënë Jeta Krasniqi, analiste në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), i cili monitoron punën e Kuvendit të Kosovës.

Ky projektligj është në përfundim dhe buxheti për vitin e ardhshëm pritet të jetë 2.4 miliardë euro. Në bazë të procedurave ligjore, fundi i tetorit (31 tetor) është koha kur qeveria duhet ta miratojë propozim-buxhetin për vitin fiskal dhe ta dorëzojë në kuvend, kurse afati përfundimtar kur duhet të miratohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës është fundi i dhjetorit (31 dhjetor). Duke marrë parasysh se vendimmarrja në Kuvendin e Kosovës vazhdon të jetë problematike për shkak të mungesës së kuorumit (numrit të mjaftueshëm të deputetëve të pranishëm në seancë për votim), Kosova rrezikon që Projektligji për buxhet të mos votohet në afatet e caktuara ligjore, ka vlerësuar Jeta Krasniqi nga KDI-ja.

"E njëjta sfidë mund të jetë edhe për Projektligjin për buxhetin. Nëse një qeveri nuk mund ta kalojë Ligjin për buxhetin, ajo shihet si tip mocioni mosbesimi, pasi buxheti është mjet, përbrenda të cilit një qeveri mund ta shtyjë përpara programin e saj qeverisës", ka thënë Krasniqi. Sipas saj, Qeveria e Kosovës do të përballet me vështirësi në sigurimin e votave të mjaftueshme për të votuar buxhetin. Pamundësia e sigurimit të votave për miratim të ligjeve nga qeveria aktuale, sipas Krasniqit, është vërtetuar më së miri me Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike, që në tentativën e shtatë ka arritur të miratohet në lexim të parë, pikërisht për shkak të mungesës së kuorumit.

Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se projektligji në fjalë është në fazën përfundimtare dhe brenda dy javësh pritet të dërgohet për miratim në qeveri, e më pas në Kuvend. "Kështu që sfida do të ketë, por në rrethana aktuale, si Ministri e Financave, jemi duke bërë më të mirën e mundshme që të përgatisim një buxhet, i cili është qëndrueshëm dhe brenda rrjedhave ekonomike", ka thënë Krasniqi.

Mungesa e unitetit politik dhe përçarjet politike janë bërë probleme më të mëdha në Kosovë sesa pandemia e shkaktuar nga koronavirusi dhe kjo do të reflektojë edhe në mosmiratimin e Projektligjit për buxhetin 2021, ka thënë Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike. "Në këtë drejtim besoj se vota e deputetëve duhet të jetë obligim moral për ta, që për shtet të bëjnë më tepër sesa për interesa personale, klanore dhe interesa politike. Në këtë situatë besoj se Kosova meriton dhe kërkon një bashkërendim të të gjithë akterëve relevantë politikë, por kjo nuk po ndodh, kështu që druaj se viti 2021 do të jetë edhe më sfidues", ka thënë Gërxhaliu.

Nëse buxheti nuk miratohet deri më 31 dhjetor, atëherë në bazë të procedurave ligjore, Kuvendi, me anë të një vendimi, mund të autorizojë vazhdimin e zbatimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal, në asnjë rast, nuk mund të vazhdojë të zbatohet për më gjatë se tre muaj të vitit të ardhshëm fiskal. Me të gjitha sfidat eventuale që mund të paraqiten për miratimin e Projektligjit për buxhetin, Gërxhaliu ka vlerësuar se në planifikimet buxhetore duhet të përfshihet edhe një rezervë shtetërore, në rast të vazhdimit të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi. Por, Agim Krasniqi nga Ministria e Financave ka treguar se një pjesë e programit nga Projektligji për rimëkëmbje ekonomike do të vazhdojë të ekzekutohet edhe vitin tjetër. Kurse në projeksionet e tjera buxhetore, ka thënë ai, nuk është paraparë që të ketë mbyllje të ekonomisë vitin e ardhshëm për shkak të pandemisë Covid-19, që e shkakton koronavirusi. Edhe në raportin e fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar thuhet se "duke pasur parasysh zhvillimin e pasigurt të pandemisë, buxheti për vitin 2021 duhet të përfshijë një alokim të përgjithshëm të rezervës për masat zbutëse që mund të vendosen në gjysmën e parë të vitit 2021, nëse është e nevojshme". Për shkak të pandemisë, Kosova, sipas Ministrisë së Financave, gjatë këtij viti ka shënuar rënie ekonomike për 6.5 për qind. Njëjtë ka parashikuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, ndërsa kthimi më 2021, sipas FMN-së, do të jetë në intervalin 4.5 - 6 për qind.

# Veseli: Fermerët kanë nevojë për përkrahje, të konsumohen prodhimet vendore



PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Lideri i Partisë Demokratike Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar të enjten një fermë pulash dhe stallë lopësh në fshatin Korishë të Prizrenit, ku ka biseduar me blegtorët dhe banorët për gjendjen e tyre ekonomike.

Veseli në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se fermerët e Kosovës kanë nevojë për ndihmë nga institucionet shtetërore qendrore dhe lokale dhe nga e gjithë shoqëria. "Vizitova një fermë pulash dhe stallë lopësh në fshatin Korishë të Prizrenit, ku bisedova me blegtorët dhe banorët për gjendjen e tyre ekonomike, si dhe dëmet që kanë pasur prej pandemisë. Fermerët tanë kanë nevojë jo vetëm për ndihmë nga institucionet shtetërore qendrore e lokale, por edhe për përkrahje nga e gjithë shoqëria. Të gjithë ne duhet ta shohim si obligim moral që t'i ndihmojmë të dalin nga situata e vështirë e tyre duke konsumuar sa më shumë prodhime vendore", ka shkruar Veseli.

## "Termokos"-i fillon furnizimin me ngrohje



PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Ndërmarrja publike "Termokos" ka filluar të enjten sezonin e ri ngrohës 2020/2021. Kjo ndërmarrje ka njoftuar se bazuar në Ligjin për ngrohje, rregulloret e ZRrE-së dhe kushtet klimatike, tanimë janë plotësuar parakushtet për ta filluar furnizimin me ngrohje. Sipas kësaj ndërmarrje, paraprakisht janë zhvilluar me sukses gjithë përgatitjet e nevojshme, riparimet e rrjetit e nënstacioneve të ngrohjes, testimet e pajisjeve e rrjetit dhe si rrjedhojë që nga mëngjesi ka filluar furnizimi me ngrohje për afro 15 mijë konsumatorë. Furnizimi me ngrohje do t'i përshtatet lëvizjes së temperaturave të ajrit dhe nevojave të konsumatorëve për ngrohje.

Kryeshefi ekzekutiv i "Termokos"-it, Arsim Fetahu, ka shprehur optimizëm se edhe ky sezon do të jetë i suksesshëm. Ai ka shprehur kënaqësinë e tij, që në kuadër të fazës së dytë të projektit për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ngrohjes, që është realizuar me fondet e Komisionit Evropian, sivjet për herë të parë do të fillojnë të furnizohen me ngrohje të mjaftueshme dhe cilësore çerdhja "Xixëllonja", shkolla "Meto Bajraktari", objekti i Teatrit Kombëtar, Opera e Kosovës, Ministria e Kulturës, Prokuroria Speciale, 5 objekte të vjetra banesore të lagjes "Ulpiana" , ndërsa pas pak kohësh do të kyçen në rrjetin e ngrohjes edhe 6 objekte të reja banesore të lagjes "Mati 1".

Privilegji për startimin e sezonit ngrohës i ka takuar Qemajl Limonit, i cili është punëtori më i vjetër i ndërmarrjes.

# Prezantohet master plani i ujitjes së tokave bujqësore



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në takimin e Këshillit Ndërministror të Ujërave, ka thënë se qeveria është e përkushtuar që ta zhvillojë sektorin e ujërave. Ndërsa ministri i Bujqësisë, Besian Mustafa, ka prezantuar master planin e ujitjes së tokave bujqësore. Ai ka thënë se ky master plan parasheh përfshirjen e të gjitha tokave bujqësore në sistemin e ujitjes. Sipas Mustafës, me zbatimin e tij do të rritet hapësira e tokave bujqësore që përfshihen nën ujitje, nga 20 mijë hektarë në 90 mijë hektarë. Ai ka sqaruar se për zbatimin e këtij master plani do të nevojiten 590 milionë euro investime

**Prishtinë, 15 tetor (ER)** - Të enjten është mbajtur takimi i 11-të i Këshillit Ndërministror të Ujërave. Ky takim është kryesuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ku të pranishëm kanë qenë edhe ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, zëvendësministri i Shëndetësisë, Pjetër Ndou, si dhe ambasadori i Zvicrës, Thomas Kolly dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde. Fillimisht, Hoti ka falënderuar vendet donatore, veçmas Zvicrën dhe Gjermaninë, që e kanë ndihmuar zhvillimin e sektorit të ujërave në vendin tonë, me ç'rast ka dhënë përkushtimin maksimal të qeverisë për sektorin e ujërave, si një sektor tepër i rëndësishëm. Në këtë takim është miratuar rekomandimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e kanalit të Lepencit dhe digave në Firajë dhe Shtime në dy faza, mbi bazën e të cilit do të aplikohet në raundin e radhës të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për dizajnin preliminar, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social, si dhe përgatitjen e dosjes së tenderit të këtij projekti, përmes të cilit do të sigurohet uji i pijshëm për rajonin e Gjilanit, Ferizajt dhe Prishtinës. Po ashtu, në këtë takim është miratuar edhe korniza e investimeve- master plani për ujitje si një projekt i rëndësishëm strategjik i cili do të ketë ndikim të madh në sektorin e bujqësisë, përmes të cilit do të shtohet mbulueshmëria e ujitjes së tokave bujqësore.

Me këtë rast, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka thënë se master plani parasheh përfshirjen e të gjitha tokave bujqësore në sistemin e ujitjes. Sipas Mustafës, me zbatimin e këtij master plani do të rritet hapësira e tokave bujqësore që përfshihen nën ujitje, nga 20 mijë hektarë në 90 mijë hektarë. Më tutje, ai ka sqaruar se për zbatimin e këtij master plani do të nevojiten 590 milionë euro investim. "Ky investim në ujitje do të jetë për bujqësinë tonë, për ta shumëfishuar prodhimin bujqësor dhe të ushqimit cilësor për familjet tona", ka thënë Mustafa.

Ndër të tjera, në këtë takim është shqyrtuar edhe qasja për vendosjen e caqeve dhe treguesve të performancës për kompanitë rajonale të ujësjellësve dhe kompanive rajonale të ujitjes, me qëllim të përmirësimit të qeverisjes korporative të këtyre ndërmarrjeve. Gjithashtu, është diskutuar edhe gjendja aktuale e projekteve në sektorin e ujërave për të cilin u kërkua të bëhet një analizë me e hollësishme si dhe u miratuan rekomandimet sa i përket "Raportit për financimin e borxhit ndërkombëtar për investime në infrastrukturën ujore të Kosovës – aspekti ligjor dhe ekonomik". Në kuadër të diskutimit ishte edhe shqyrtimi i zbatimit të dispozitave të ligjit për ujëra, ku Këshilli ka marrë vendim që të kërkojë nga institucionet përgjegjëse raport për zbatimin e ligjit.

# Abrashi: Zhvillimi i aviacionit civil, prioritet i qeverisë

**Prishtinë, 15 tetor (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka zhvilluar një vizitë pune në zyrat e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ku është takuar me drejtorin e përgjithshëm, Bujar Ejupi, kryesuesin e bordit mbikëqyrës, Skender Halili, si dhe me ekipin menaxhues. Me këtë rast, Abrashi ka treguar për angazhimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe qeverisë Hoti për zhvillimin e sektorit të transportit ajror, duke u fokusuar në normalizimin e hapësirës ajrore, hapjen e tregut për shërbime sa më të mira për kompanitë ajrore dhe uljen e kostove që ndërlidhen me shfrytëzimin e shërbimeve në Aeroport.



"Qeveria e Kosovës e ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e Aviacionit Civil. Transporti ajror ka rëndësi jetike për ekonominë e Kosovës dhe për diasporën e kosovës. Dhe veprimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari' të jetë konkurrues me aeroportet e rajonit dhe të ofrojë bileta më të lira për udhëtarët", ka deklaruar ai.

Ndërsa drejtori i aviacionit, Bujar Ejupi, e informoi ministrin për aktivitetet e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) si agjenci e pavarur, rregullatore e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Ai ka deklaruar se AAC-ja brenda mekanizmave ndërkombëtarë bën përpjekje të vazhdueshme për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore të Kosovës në bashkëpunim me NATO-n dhe partnerët e tjerë. "Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, do ta përfshijë hapjen e korridoreve të reja ajrore në mes të Republikës së Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP 'Adem Jashari' dhe për mbikalime në hapësirën e ultë ajrore", ka deklaruar Ejupi.

# Jashari: Do të jemi afër çdo familje që ka nevojë



SKENDERAJ, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me zyrtarë komunalë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Qendrës Burimore për Personat e Zhdukur si dhe Familjarët e të Pagjeturve, me të cilët ka biseduar rreth trajtimit që po u bëhet këtyre familjeve nga ana e institucioneve të Kosovës.
Gjatë këtij takimi kryetari Jashari shprehi edhe një herë pakënaqësi ndaj institucioneve qendrore të cilat nuk kanë bërë aq sa duhet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. "Si kryetar i komunës, tregova gatishmëri të plotë se do të jemi afër çdo familje që ka nevojë e, po ashtu, ne si komunë jemi të hapur për bashkëpunim në mënyrë që sa me parë ta mbyllim këtë plagë të madhe të shoqërisë sonë", tha tutje Kryetari Jashari.
Ndërsa udhëheqësi i Qendrës Burimore për Personat e Zhdukur, Bajram Qerkini, ka bërë me dije se Komuna e Skenderajt është një ndër komunat e vetme e cila merret me çështjen e personave të pagjetur ku edhe vetë familjaret e kanë konfirmuar dhe janë shprehur të kënaqur me mënyrën se si trajtohen nga komuna.

## Lladrovci takohet me shkrimtarin Riza Greiçevci



DRENAS, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të enjten ka pritur në takim gazetarin, shkrimtarin dhe publicistin e njohur nga Drenasi, Riza Greiçevci. Me këtë rast, shkrimtari Greiçevci ia ka dhuruar kryetarit Lladrovci librin e tij më të fundit, "Hero në luftë, hero në paqe", kushtuar jetës dhe veprimtarisë së presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.
Kryetari Lladrovci e ka vlerësuar krijimtarinë jetësore të shkrimtarit Greiçevci dhe e ka përgëzuar për botimin më të ri dhe tematikën e trajtuar, duke i uruar shëndet dhe vazhdim të frytshëm të krijimtarisë letrare.
Riza Greiçevci deri më tani ka botuar më se 106 vepra të gjinive të ndryshme letrare. Prej tyre 26 kanë motive nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Shkrimtari Greiçevci ka pranuar një numër të madh të mirënjohjeve, shpërblimeve e dekoratave për vlerësim të veprimtarisë së tij atdhetare e artistike.

## Komandanti regjional i KFOR-it vlerëson lart punën e kryetarit të Junikut

JUNIK, 15 TETOR (ER) - Komandanti regjional i KFOR-it, kolonel Gianluca Figus, ka vizituar Komunën e Junikut, ku është mirëpritur nga kryetari i këtij komune, Agron Kuçi, i cili e ka njoftuar me historikun e Junikut, objektivat komunale, prioritetet, zhvillimet dhe gjendjen epidemiologjike.
Kolonel Gianluca Figus ka vlerësuar lart punën dhe angazhimin e Komunës së Junikut si në zhvillim lokal, po ashtu edhe në angazhim për promovimin e Kosovës përmes projektit "Agenda 2030" dhe për qasjen e hapur për bashkëpunim, mundësi e mirë e zhvillimit të projekteve të përbashkëta me ndikim në komunitet.
Kryetari i Komunës së Junikut dhe komandanti regjional, kolonel Figus kanë diskutuar rreth mundësisë së binjakëzimit të Komunës së Junikut me komuna nga Italia me karakteristika dhe prioritete të ngjashme dhe avancimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm me qëllim të krijimit të bashkëpunimit tradicional ndërshtetëror.



# Vazhdon shpërndarja e farës dhe plehut kimik për mbjelljet vjeshtore në Malishevë

MALISHEVË, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, nga pika shpërndarëse e farës dhe plehut kimik për 549 bujq, është njoftuar nga drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, për ecurinë e punës e cila ka shkuar sipas planifikimit dhe dinamikës që po vazhdon edhe në ditën e katërt të shpërndarjes së farës dhe plehut kimik për mbjelljet vjeshtore. Me këtë rast, kryetari Begaj është zotuar se do të vazhdojë t'i mbështesë bujqit malishevas. "Kam gatishmërinë e qeverisë komunale, për përkrahje të vazhdueshme për të gjithë bujqit dhe fermerët e Komunës së Malishevës jo vetëm për mbjelljet vjeshtore, por do të ndihmohen edhe për të gjitha degët e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë si dhe me pajisje të mjeteve të punës edhe në të ardhmen, sepse Malisheva është një rajon bujqësor dhe vetëm me punë e përkushtim do ta rrisim mirëqenien tonë dhe zhvillimin ekonomik'", ka thënë Begaj.
Ky projekt financohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



# A do të ketë zgjedhje të jashtëzakonshme në Kosovë? Definitivisht jo!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**1. Sinqeriteti i pasinqertë:** Menjëherë pasi qeveria Kurti nuk e përballoi mocionin për mosbesim të propozuar nga partneri kryesor, LDK-ja, pas qetësimit të stuhisë, përsëri u ringjallën pasionet për pushtet përmes zgjedhjeve të reja, në emër të legjitimitetit qytetarë. Natyrisht se më të zëshmit për zgjedhje të reja ishin "skifterët" apo "dragonjtë" e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) e që në LV aderuan kur nuk iu mbeti vend tjetërkund, prandaj mungesën e të qenit në përmbajtje dhe bindje LV, këtë e kompensuan me fjalorë të fortë, denigrues, përjashtues, fyes, damkosës dhe diferencues. Realisht, këta ishin dhe janë anëtarë të LV-së për aq sa unë jam anëtar i Partisë Popullore Kurde! Këta, në fakt, më së shumti i kanë dëmtuar dhe po e dëmtojnë LV-në sepse një të kaluar jopatriotike dhe pa përmbajtje, në jo pak raste edhe kundër LV-së po e mbështjellin me një cipë të pacipë të patriotizmit ekstrem! Prandaj, nga overpatriotizmi e pësuan vdekjen e menjëhershme politike. Realisht, në LV patriotët e vërtetë mbetën nën hijen e patriotëve mashtrues, si veteranët mashtrues! Se LV-ja kërkon zgjedhje nuk ka asgjë të keqe për faktin se vlerëson se do t'i fitojë ato zgjedhje madje, siç deklarojnë me më shumë se 50 për qind të votave. Edhe këtu kanë të drejtë, ëndrrat nuk janë të ndaluara, për to nuk paguhet tatim dhe sipas ligjeve në fuqi në Kosovë, ato edhe nuk sanksionohen në asnjë mënyrë. Për aq kohë sa janë ëndrra! Jam i sigurt se LV-ja i fiton zgjedhjet, pa asnjë dyshim, por se dallojmë te përqindja. Nëse të themi e që unë nuk besoj zgjedhjet do të mbahen në 6 muajt e ardhshëm, LV-ja do të fitojë 35-40 për qind të votave, pa bërë koalicion me askënd. Nëse zgjedhjet do të mbahen pas 9 muajve LV-ja do ta ketë vështirë t'i fitojë edhe 30 për qind të votave kurse, nëse zgjedhjet mbahen pas 12 muajve LV nuk e kalon 26 për qind të votave. LV-ja po e bën një gabim të pafalshëm për një parti që ka për qëllim t'i fitojë zgjedhjet dhe të qëndrojë gjatë në pushtet; nuk e ka bërë një analizë të sinqertë për shkaqet të cilat ndikuan që aq shpejt të katapultohet nga pushteti dhe qeverisja por se është vënë në situatë të shokut Zulo e që do të jetojë mbi famën e së kaluarës. LV-ja duhet ta ketë të qartë se të gjithë ata që janë bërë bashkë për ta rrëzuar nga pushteti në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë të mbahen zgjedhjet në kohën ku LV-ja është thuaja në majat e popullaritetit dhe të përkrahjes. Pastaj, proceset që po zhvillohen rreth Kosovës e jo për Kosovën thuaja janë përcaktuese për pohimin tim se nuk do të ketë zgjedhje, as të shpejta e as kur i përshtatet LV-së. Rrobaqepësit e fatit të Kosovës duket se e kanë marrë masën e rrobave të cilat Kosova domosdoshmërisht do t'i veshë pavarësisht nëse janë të ngushta, me mëngë të shkurtra apo me prapanicë të lakuriqur! Pastaj, faktori ndërkombëtar e ka krijuar një hartë politike që i përshtatet në Ballkan dhe nuk do të lejojë që investimi i tyre të shkojë huq në Kosovë përkundër faktit se Kosovës nuk po i ofrojnë as zgjidhje të drejtë e as zgjidhje të ndershme por kompromis, madje të dhimbshëm! Ndërkombëtarët e legjitimuan autokracinë e Aleksandër Vuçiqit, e cila u bë shtet si në kohën e Sllobodan Milloshevqit, thuaja pa opozitë fare. E siguruan gjithashtu vijimësinë politike të Zoran Zaevit në Maqedoninë e Veriut sikur që i thyen këmbët politike të pushtetit 30-vjeçar të Millo Gjukanoviqit, duke e përkrahur një qeveri me ortodoksizëm politik, të maskuar si qeveri e ndryshimeve dhe duke e përligjur modelin grek ku Kisha Ortodokse është vet shteti apo edhe mbi shtetin. Ndërkombëtarët nuk duan ta rrëzojnë nga pushteti Dodigun e Republika Serpskas sepse e ruajnë si xhoker në ridisajnimin e ndryshimeve politike në Ballkan ku as kufijtë nuk llogariten të paprekshëm nga ndryshimet eventuale. Republika Srpska i rri si shpatë mbi kokë Kosovës përmes Asociacionit të Komunave të Serbisë në Kosovë. LV-ja duhet të kërkojë aleatë brenda pozitës dhe opozitës në Kosovës dhe autoritarizmin që e zbatuan gjatë 50 ditëve përmes spastrimeve klasike duhet ta kujtojnë si një të kaluar të keqe që i lë, edhe pa pushtet, edhe pa aleatë ! Nëse LV-ja e kupton se nuk do të ketë zgjedhje të shpejta dhe në kohën kur vetëm asaj i përshtaten, atëherë do ta ketë një të ardhme politike më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme! Në të kundërtën, edhe nëse i fiton zgjedhjet e nuk ka dyshim se i fiton, nuk do të gjejë partnerë për të qeverisur! LV-ja nuk ka qenë pjesë e asnjë procesi të madh në Kosovë, me mosmarrjen e përgjegjësisë së qeverisë Kuri për bisedime, e ka përjashtuar veten nga loja. Ka mundur dhe ka pasur detyrim kushtetues Albin Kurti që t'i udhëheq bisedimet, dhe nëse do të ishin të dëmshme për Kosovën, topin e vendimmarrjes është dashur ta adresojë të Kuvendi i Kosovës. Mua më duket se ndërkombëtarët për marrëveshje përfundimtare me Serbinë nuk kanë kërkuar për partnerë as Albin Kurtin e as krahun e luftës. Në fund të fundit, nuk iu kanë besuar, prandaj Albinin e nxorën jashtë loje pasi ai nuk diti dhe nuk luajti sipas rregullave të përcaktuara nga ata kurse krahut të luftës ia lëshuan Gjykatën Speciale. Edhe nëse nuk i dënojnë, atëherë për një kohë të caktuar i nxjerrin nga fusha e lojës dhe vendimmarrjes! Personalisht nuk i besoj Trumpit dhe Grenellit se kanë ndonjë qëllim të mirë, kurse Lajçakun dhe Borrellin më shumë i konsideroj si pjesë e ekipit të Serbisë se që janë të paanshëm dhe korrekt! Por, i forti t'i prenë teshat sipas masës së tyre!

**2. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK):** Mund edhe të mos pajtoheni me LDK-në, por duhet ta pranoni se tani po e udhëheq vallen. Edhe më pak mund të mos pajtoheni me Isa Mustafën, por duhet ta pranoni se aktualisht është politikani pa të cilin nuk bëhet asnjë zgjidhje dhe asnjë proces. Është interesant fakti se Isa Mustafa më shumë kontestohet nga vet LDK-ja se nga opozita. Opozita nuk e sulmon shumë dhe fort për faktin se e ruan si partner të mundshëm. Pastaj, Isa Mustafa po i luan shumë mirë lojërat politike dhe është shumë më larg në këtë drejtim krahasuar me kundërshtarët në opozitë që, në vend të argumenteve, po përdorin fyerje personale, familjare etj. Prandaj edhe nuk e kanë efektin e duhur. Kryeministri aktual, Avdullah Hoti ndonëse e drejton një qeveri me këmbë të qelqit, dhe nën hijen e Isa Mustafës, pahetueshëm po punon më krijimin e rrjetëzimit të bashkëpunëtorëve që ia forcojnë pozitën në kohën kur thuaja të gjithë ndërkombëtarët po e pranojnë si partner të besueshëm. Me Serbinë, së paku në planin deklarativ po mbanë qëndrim të fortë prandaj, ose do të kacavjerret majave të pushtetit ku edhe do të qëndrojë, ose do ta marrë "vellika teposhtëzën" siç thonë në qytetin e origjinës. Është krejt e natyrshme që LDK-ja kundërshton zgjedhje të reja në kohën kur është në pushtet, i tillë siç është dhe kur po udhëheq me procese duke premtuar zgjidhje që nuk e dëmton Kosovën në asnjë aspekt.

**3. Partia Demokratike e Kosovës (PDK):** Pas zgjedhjeve të fundit PDK-ja vendosi një standard që i kishte munguar Kosovës, i pranoi rezultatet e zgjedhjeve, kaloi në opozitë ndonëse kishte mundësi të bëhej pjesë e kombinimeve për formim të qeverisë. Deklaroi se në asnjë rrethanë nuk do të bëhet pjesë e qeverisë, kundërshtoi disa procese politike, mirëpo në anën tjetër u deklarua se do të votojë çdo ligj apo nismë që është në interes të Kosovës. Fillimi i opozitarizmit ishte i mirë dhe i drejtë, ndërsa filloi të lëkundet pas ftesave nga Gjykata Speciale, që si shpata e Demokleut u vendos mbi kokën e figurave kryesore të PDK-së, që janë tani në këtë parti apo janë në subjektet tjera politike. Sot, opozitarizmin e PDK-së po e përcakton Gjykata Speciale dhe duket se edhe e ka pasur një qëllim të tillë, midis qëllimeve tjera. Në PDK ishte etabluar një shtresë parazitësh politikë që nuk punonin asgjë për partinë, por që nga partia nxirrnin vetëm përfitime. Për shkak të jetëgjatësisë së PDK-së në pushtet, kjo shtresë parazitësh u ashtëzua dhe kundërshtonin çdo reformë apo ndryshim brenda partisë. Tani, me veshë cucë po presin veprimet e Gjykatës Speciale. E pandershme dhe e pamoralshme. PDK-ja nuk mund të bëjë planifikime strategjike për faktin se Gjykata Speciale nuk ia certifikon ato planifikime, madje po bënë përpjekje t'i shkatërrojë ato. Tash në PDK kemi kakofoni mendimesh dhe qëndrimesh, ata që ishin edhe para formimit të PDK-së, për shkak të rrethanave të krijuara janë të kufizuar në veprime kurse ata që kurrë nuk kanë qenë PDK ose janë bërë PDK për shkak të përfitimeve, kanë nxjerrë kokën e strucit dhe po e luajnë rolin e shqiponjave. Përkundër deklarimit se PDK-ja është e gatshme për zgjedhje mendoj se në këto rrethana nuk i konvenojnë zgjedhjet aspak. Kjo i bie sikur kur besimtarët mashtrues thonë se: "çka vjen prej Zotit, mirë se ardhtë (madje edhe vdekja), por se nuk lënë gjë pa bërë për t'i shpëtuar vdekjes…". Edhe PDK-ja duhet të deklarohet se është për zgjedhje por, në anën tjetër të lutet të mos ketë zgjedhje, deri në një sqarim të situatës.

**4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK):** Mbajtjen e zgjedhjeve i përdorë si gulinov nëse Ramush Haradinaj nuk zgjedhet president. Është gabim për faktin se kartën më të fortë e kanë zbuluar shumë herët! Pastaj, besoj se janë të informuar se asnjëherë zgjedhja e Presidentit në Kosovë nuk është bërë pa ndërhyrjen diskrete (në pikë të ditës dhe publikisht) të ndërkombëtarëve, qofshin ata banditë apo mashtrues. Ibrahim Rugova e kishte përkrahjen e ndërkombëtarëve sikur më vonë edhe Fatmir Sejdiu. Behgjet Pacolli u bë president prej koçeve të Pushikarit dhe Dellit sikur që edhe Fetja u bë presidente nga zarfi i Dellit. Edhe Hashimi u bë president me ndihmën e terminalëve, falë përkrahjes bujare të ambasadorëve të ardhshëm e që ishin deputetë, dhe pa asnjë dyshim me përkrahjen e ambasadave në Prishtinë. Edhe Ramushin, si njërin nga kandidatët e mundshëm për president e pret "një kontrollim teknik" në ambasadat e huaja në Prishtinë sikur që edhe kandidatët tjerë, për t'u bërë president duhet ta sigurojnë Kartonin e Gjelbër - Green Card të koçemëdhenjve ndërkombëtarë dhe vetëm pastaj do t' i nënshtrohen një "votimi demokratik" në Kuvendin e Kosovës. Nëse seriozisht krijohen kushte për zgjedhje, AAK-ja mund të përafrohet me LV-në.

**5. Nisma për Kosovën dhe AKR:** janë të interesuar për zgjedhje të jashtëzakonshme për aq sa unë jam i interesuar ta ndërroj emrin, nga Behxhet Shala, në Aleksandër Vulin!

Prandaj, të gjitha këto që i ceka më lartë më japin një siguri se zgjedhje të jashtëzakonshme nuk do të ketë në Kosovë aq më parë që Borrell dhe Lajçak deklaruan se marrëveshje me Serbinë është çështje muajsh. Ndërkombëtarët në Kosovë nuk janë këtu për t'ua plotësuar dëshirat e partive politike nëse nuk jeni vet Lista Serbe që ka një status të privilegjuar në Kosovë ashtu sikur Kisha Ortodokse në Serbi, Greqi e tash edhe në Mal të Zi. Në vend të kësaj, shprehje dëshirash për zgjedhje sepse më përshtaten tash, opozita dhe pozita duhet të mobilizohen që të pengojnë që dëmi që do t'i bëhet Kosovës të jetë sa më i vogël. Se Kosova do të dëmtohet, për këtë nuk e kam asnjë dyshim!!!



*Stevie Nicks më 1985 (foto: Donaldson Collection/Getty Images)*

# Stevie Nicks për muzikën, moshën dhe pavarësinë

**Legjenda e muzikës rok, Stevie Nicks, rrëfen jetën e saj. Pjesë të shkrimit të gazetares së ditores "Guardian", Jenny Stevens.**

Stevie Nicks, pandeminë e ka marrë më seriozisht se shumica. Këtë vit, rrallë e hiç ka dalë nga shtëpia e saj në Los Anxhelos. *"Ndihmësja ime, Zoti e bekoftë, e vesh kostumin e saj të hazmatit dhe shkon për të marrë ushqimet, ndryshe do të vdisnim nga uria"*, thotë Nicks.

Ajo u sëmur rëndë në mars të vitit 2019, duke përfunduar në kujdesin intensiv me pneumoni të dyfishtë. Pas kësaj tronditjeje, ka frikë se kontraktimi me Covid-19 mund t'i japë fund karrierës së saj si këngëtare.

Por, çfarë do të thotë për të që ta ndalë këndimin?

*"Kjo do të më vriste"*, thotë ajo. "Nuk është veç këndimi, sepse nuk do të performoja më kurrë, nuk do të kërcej më nëpër skenat e botës".

Ndalet dhe psherëtin.

*"Në moshën 72-vjeçare nuk jam e gatshme të heq dorë nga karriera ime"*.

Kur ne flasim në telefon, është gati mesnatë në Los Anxhelos. Nuk është problem për të, meqë është "person i natës". Vitin e kaluar, natën që u sëmur u bë gruaja e parë që u fut në "Rock and Roll Hall of Fame", për të dytën herë – një nder ky që pasqyron suksesin e madh si një nga këngëtarët kryesorë të grupit Fleetwood Mac dhe si solo artiste, si autore dhe këngëtare e këngëve magjike për dashurinë dhe lirinë, përfshirë *"Dreams"*, *"Rhiannon"*, *"Gold Dust Woman"*, *"Landslide"* dhe *"Edge of Seventeen"*.

E pyes për pikëpamjet e saja shpirtërore. Thotë se përkundër frikës për karrierën e saj, *"disa njerëz me të vërtetë kanë frikë të vdesin, por unë jo. Gjithmonë kam besuar te forcat shpirtërore. E di se nëna ime është përreth meje, gjatë gjithë kohës"*.

Nicks ishte e lidhur me nënën e saj Barbara, e cila e shtynte të vazhdonte karrierën. Ndërsa, të drejtat e grave i ka pasë në mendje që nga vdekja e "heroinës" së saj, gjykatëses supreme Ruth Bader Ginsburg, muajin e kaluar.

*"Të drejtat e abortit ishin lufta e brezit tim"*, thotë ajo.

Nicks e ndërpreu një shtatzëni, në vitin 1979, kur grupi Fleetwood Mac ishte në kulmin e famës e ajo ishte në lidhje me këngëtarin e grupit "Eagles", Don Henley. Çfarë do të thotë të jesh në gjendje ta bësh atë zgjedhje?

*"Nëse nuk do ta kisha kryer atë abort, jam shumë e sigurt se nuk do të kishte Fleetwood Mac. Thjesht, nuk kisha mundësi të kem fëmijë atëherë, duke punuar vazhdimisht. Dhe, merrja shumë drogë…"*! Pauzon.

*"Dhe, e dija se muzika që do të sillnim në botë do të shëronte zemrat e shumë njerëzve e do t'i bënte ata njerëzit të lumtur. Ndaj thash: E dini çka? E kjo është me e rëndësishme. Nuk ka tjetër grup në botë që ka dy këngëtare kryesore, dy gra kryesore – si autore. Ky ishte misioni im botëror"*.

Fleetwood Mac e solli albumin "Rumours" më 1977 – album që u bë i famshëm aq sa drama e bërjes së këngëve për të. U shit në më shumë se 40 milionë kopje dhe vazhdon të arrijë tek dëgjuesit e rinj. Veç javën e kaluar, një nga hitet më të mëdha të tij, "Dreams" (krijuar nga Stevie Nicks), u bë pjesë e një trendi viral në TikTok. Problemet e grupit u shfaqën në album: Nicks dhe i dashuri e partneri i atëhershëm muzikor, Lindsey Buckingham, u ndanë; John dhe Christine McVie, basisti dhe pianistja/këngëtarja e bendit, u shkurorëzuan; dhe, martesa e bateristit Mick Fleetwood u shkatërrua.

Nicks ka performuar që në moshën pesëvjeçare, kur gjyshi i saj, këngëtar i muzikës kantri në Feniks të Arizonës, e vinte në skenë për të kënduar. U takua me Buckinghamin në vitin e fundit të shkollës së mesme. Çifti iu bashkua grupit Fleetwood Mac më 1975. Buckingham u largua nga grupi më 1987. U kthye më vonë, por u pushua më 2018.

A ka folur me Buckinghamin qëkur u largua nga grupi?

*"Jo"*.

A mendon se nuk do të dilni më në skenë me të?

*"Ndoshta kurrë"*

Me të vërtet?

*"Uh-uh"*, thotë ajo, duke vërtetuar "Jo"-në.

Thotë se njerëzit gjithmonë e pyesin grupin: *"A kaloni mirë"?*

*"Përgjigjemi: 'Jo tamam'. Vazhdojnë: 'Jeni miq'. 'Jo tamam'. 'A shiheni kur nuk jeni në turne'? 'Jo'. Dhe kjo është kështu që nga viti 1976"*.

Kur albumi i saj i parë solo, "Bella Donna," kryesonte toplistat më 1981, ajo ia dha Buckinghamit një kopje. E la atë në dyshemenë e studios dhe kurrë nuk e dëgjoi.

*"Ata ishin xhelozë. Dhe, e dini çka? Duhej të mos ma ndiente"*.

"Ata" ishin në anëtarët e grupit apo producentët?

*"Oh, të gjithë ata. E urrenin atë lloj besimi tek një grua"*.

E kujton diskutimin me babanë, në shtëpinë familjare, menjëherë pasi doli "Bella Donna", kur ajo ishte 35 vjeçe.

→

*"Dhe babai tha: 'Stevie, a nuk do të martohesh kurrë'? Nëse Christine do të ishte në dhomë me mua, do të thoshte se të dyja kemi vendosur të mos kemi fëmijë e që ta ndjekim muzën tonë muzikore nëpër botë".*

Por Nicks u martua një herë, më 1982, me ish-burrin e shoqes më të mirë të shkollës së mesme, Robin Anderson. Robina u diagnostikua me leukemi, teksa ishte shtatzënë me fëmijën e saj të parë. Vdiq menjëherë pas lindjes. Martesa e Nicksit me të burrin e saj Kim, zgjati tre muaj.

*"Nuk ishte martesë. E bëmë për t'u kujdesur për djalin e saj. Tri javë më vonë, e kuptuam se nuk do të funksiononte".*

Djali i Robinës dhe Kimit, Matthew, tash e ka një vajzë që quhet sipas nënës së ndjerë.

*"Robina e vogël është pesë vjeçe. Krishtlindjen e kaluar, ishte në shtëpinë time. Hyri në kuzhinë, ma kapi dorën e ë tha: 'Eja me mua, gjyshe Stevie'. Thash me vete: ''A më quajti gjyshe ajo'? Atë ditë shkrova në ditarin tim: 'Të premtoj, Robin, se do të jem gjyshja Stevie derisa vdekja të na ndajë'. Jeta i ka këto kthesa të çuditshme. I them shoqes Robin, që vdiq shumë kohë më parë: 'Shiko përmes syve të mi, mbesën tënde'. Ishte e jotja e tani është e imja".*

Kur kthehet prapa, keqardhja e vetme e saj janë tetë vjetët e varësisë nga qetësuesi Klonazepam (shitet si Klonopin). Nisi më 1986, kur një psikiatër ia përshkroi këtë ilaç për ta ndihmuar që të flinte, pasi doli nga rehabilitimi për shkak të varësisë nga kokaina.

*"Është ilaç shumë delikat; nuk e ndjen shumë, ose kështu mendon. Në shishe shkruan: 'Merre sipas nevojës'. Është gjëja më idiote që kam dëgjuar ndonjëherë. Kështu që thoni: 'Epo, më duhet çdo dy orë'. Është varësi në një shishe".*

Kështu, rrinte në shtëpi, shikonte filma, hante ushqim të mirë, takonte miq. Por, nuk krijonte.

*"Veç ekzistoja. I largoi dramat e mia, stuhinë time, dhembshurinë, ndjeshmërinë time… gjithë gjërat që më çonin te pianoja ime. I them vetes, sot: 'Si mbijetove tetë vjet pa dramën tënde të mrekullueshme'? Kthehem prapa e mendoj: Çfarë mund të kisha bërë gjatë asaj kohe? Një album të Fleetwood Mac ose një solo album. Mund të isha martuar ose ta kisha një fëmijë apo ta adoptoja një. Më lejoni t'ju them: Nëse dikush përpiqet t'ju propozojë Klonopinin, ikni nga dhoma".*

A e di ajo se sa e bukur ishte?

*"Natyrisht që mendoja se jam e bukur. E di ti, një herë e shkrova këngën 'Vajza më e bukur në botë', po kurrë nuk doli. Niste me vargun: 'Ishte vajza më e bukur ë botë / por kjo ishte shumë kohë më parë'. Këtë ua them shumë miqve të rinj: Pa marrë parasysh sa i/e bukur je, do të plakesh dhe nuk do të dukesh si i kishe 25 vjet. Kështu që, mësohu me goditjet".*

E pyes cila është kënga më e preferuar e saj.

*"Storms"*, më thotë.

Aty ajo përshkruan lidhjen me një burrë dhe se si i dorëzohet fatit.

*"'Kurrë s'kam qenë në detin e kaltër të qetë/ gjithmonë isha stuhi'. Ishte, më fal për gjuhën, një pirdhu për Mickun"*, thotë ajo, duke iu referuar aferës me kolegun e grupit, Mick Fleetwood.

Është këngë e pavarësisë?

*"E lirisë"*, më thotë. *"Jam grua e lirë dhe kështu dua të jem".* /Telegrafi/



# Rastet kur "Nobel"-i në letërsi u nda mes dy fituesve




Ka raste kur çmimet "Nobel" ndahen mes dy apo tre fituesve, kryesisht kur studimet e tyre çojnë në një rezultat të përbashkët i cili i vjen në dobi fushës për të cilën jepet edhe vlerësimi. Por në letërsi, ngase bëhet fjalë për krijimtari artistike, një çmim i ndarë mes autorëve, i parë nga jashtë, ngjan pa kuptim.
Historia më shumë se njëshekullore e "Nobel" paraqet shumë pak raste kur kjo ka ndodhur. Nëse në fizikë ky çmim i është dhënë më shumë se një fituesi 67 herë, në kimi 49, në mjekësi 72, në shkenca ekonomike 27 dhe për paqe 32, në letërsi kjo ka ndodhur vetëm 4 herë:

**1.** Viti 1904. Laureatë të "Nobel" janë francezi Frédéric Mistral dhe spanjolli José Echegaray y Eizaguirre, të dy shumë të njohur dhe të lexuar në kohën kur jetuan dhe shkruan.
**2.** Viti 1917. Laureatë të "Nobel" janë danezët Karl Adolph Gjellerup dhe Henrik Pontoppidan. Ndonëse të dy ishin nga Danimarka, në krijimtari nuk shquhet asnjë përputhje sikurse shihet edhe në motivacionin e çmimit: i pari për poezinë dhe i dyti për prozën.
**3.** Viti 1966. Laureatë të "Nobel" janë hebreu i lindur në Austro – Hungari Shmuel Agnon dhe gjermanja Nelly Sachs. Është interesant fakti se, ndonëse Agnon ishte hebre, në motivacionin për çmimin e tij nuk përmendet lidhja mes letërsisë dhe origjinës, ndërsa për Sachs, në motivacion thuhet mes të tjerash "…dhe për të shkruarin dramatik që interpreton fatin e Izraelit me një forcë prekëse".
**4.** Viti 1974. Laureatë të "Nobel" janë suedezët Eyvind Johnson dhe Harry Martinson. I pari me motivacionin "për një art të të rrëfyerit, largpamësi në hapësirë dhe kohë, në shërbim të lirisë", ndërsa i dyti "për të shkruarën që kap pikëzat e vesës dhe reflekton kozmosin".

Duhet vënë në dukje edhe fakti se "Nobel"-i në letërsi është i vetmi që nuk është ndarë asnjëherë mes tre laureatëve. Ndoshta kjo mund të jetë një nga arsyet pse mes gjithë fushave ku ky çmim jepet, letërsia ngjall më tepër diskutim dhe pritet me më shumë kërshëri. /*"ExLibris"*

# "Suksesi nuk është çelësi i lumturisë, lumturia është çelësi i suksesit"



Albert Schweitzer ishte teolog, shkrimtar, humanist, filozof dhe mjek. Ai lindi në një familje e cila për breza të tërë i ishte përkushtuar fesë, muzikës dhe arsimit. Schweitzer hyri në studimet e tij intensive teologjike, ku u doktorua në filozofinë fetare dhe vazhdoj predikimet e tij në kisha dhe kolegje të ndryshme.
Nderimet që ai mori ishin të shumta, përfshirë Çmimin "Goethe" të Frankfurtit dhe doktorata nderi nga shumë universitete duke theksuar Çmimi "Nobel për Paqe" për 1952, të cilën e morri për filozofinë e tij, duke u bërë francezi i tetë që iu dha ai çmim. Pas tij, kanë mbetur thënie të njohura me përplot kuptime brenda tyre.

**Disa nga thëniet e Schweitzer:**
Në moshën 20 vjeçare çdo njeri ka fytyrën që i ka dhënë Zoti, në moshën 40 vjeçare fytyrën që i ka dhënë jeta dhe në moshën 60 vjeçare ka fytyrën që meriton!

Suksesi nuk është çelësi i lumturisë. Lumturia është çelësi i suksesit. Nëse bëni çfarë doni, atëherë do të bëheni të suksesshëm.

Qëllimi i jetës njerëzore është të dhuroj, të tregojë dhembshuri dhe vullnet për të ndihmuar të tjerët.

Kudo që të shkoni, mund të gjeni dikë që ka nevojë për ju. Edhe nëse është gjë e vogël, bëj diçka për të cilën nuk paguhesh, por ke privilegjin ta bësh. Kujtoni, ju nuk jetoni në një botë që është e tëra e juaja.

Në atë pikë të jetës ku talenti juaj takohen me nevojën e botës, aty është ku Zoti dëshiron që të jeni.

Nëse ke diçka që nuk mund t'ia japësh dikujt, atëherë ti nuk je poseduesi, ajo të posedon ty.



# DUA LIPA EDHE NJË HERË BËHET FYTYRA E 'PEPE JEANS LONDON'

Këngëtarja kosovare me famë botërore, Dua Lipa ka prezantuar edhe një herë koleksionin e markës "Pepe Jeans London".
Dua e cila duket fantatsike nën rrobat e kësaj marke, ka treguar se ndjehet krenare që prezanton për herë të tretë dhe të fundit për këtë markë.
"Ka qenë kaq interesante dhe argëtuese të mësosh rreth dizajnimit me një markë kaq ikonike të Londrës, e cila filloi nga e para në një tezgë në tregun e Portobello në vitet 1970", ka vazhduar ylli i muzikës pop, Lipa.
Poashtu, ajo ka theksuar se ka vendosur të bashkëpunoj me koleksionin "Denim Decades", e cila sipas saj ka stile të frymëzuara nga cdo dekadë që kur Pepe filloj shitjen.
Lajmin e bëri të ditur këngëtarja përmes postimeve në rrjetet e saj sociale, ku dukja e saj e mahnitshme është komentuar vazhdimisht nga fansat e këngëtares.
Dua Lipa është shprehur se mezi pret ta sheh kombinimin e publikut me këtë markë.





# LISTA E PLOTË E FITUESVE TË BILLBOARD MUSIC 2020

Mbrëmjen e djeshme në Teatrin Dolby në Los Angeles u ndanë çmimet " Billboard Music 2020" dhe preznatimi iu besua artistes Kelly Clarkson, shkruajnë mediat e huaja.

Pavarësisht se nuk kishte publik, Clarkson mundi të sillte një energji dinamike në skenë.

"Nata e sotme ka të bëjë me mënyrën sesi muzika na prek të gjithëve, sepse muzika lidhet me ne në shumë mënyra, pa marrë parasysh kush je", ishte shprehur ndër të tjera ajo.

Mbrëmjen e djeshme Taylor Swift dhe Billie Eilish kryesuan me më shumë nominime ndërsa më poshtë ua sjellim listën e plotë të fituesve.

**LISTA E PLOTË E FITUESVE:**

Top Artist
Billie Eilish
Jonas Brothers
Khalid
Post Malone *FITUES
Taylor Swift

Top Hot 100 Song
"Someone You Loved," Lewis Capaldi
"bad guy," Billie Eilish
"Old Town Road," Lil Nas X ft. Billy Ray Cyrus *FITUES
"Truth Hurts," Lizzo
"Señorita," Shawn Mendes & Camila Cabello

Top Male Artist
DaBaby
Khalid
Lil Nas X
Post Malone *FITUES
Ed Sheeran

Top Female Artist
Billie Eilish *FITUES
Ariana Grande
Halsey
Lizzo
Taylor Swift

Billboard Chart Achievement Award
Mariah Carey
Luke Combs
Lil Nas X
Harry Styles *FITUES
Taylor Swift

Top Song Sales Artist
Billie Eilish
Lil Nas X
Lizzo *FITUES
Post Malone
Taylor Swift

Top Social Artist
BTS *FITUES
Billie Eilish
EXO
GOT7
Ariana Grande

Top R&B Artist
Chris Brown
Khalid *FITUES
Lizzo
Summer Walker
The Weeknd

Top Country Artist
Kane Brown
Luke Combs *FITUES
Dan + Shay
Maren Morris
Thomas Rhett

Top Latin Artist
Anuel AA
Bad Bunny *FITUES



J Balvin
Ozuna
Romeo Santos

Top Christian Artist
Lauren Daigle *FITUES
Elevation Worship
For King & Country
Hillsong United
Kanye West

Top Billboard 200 Album
Billie Eilish "When We All Fall Asleep, Where Do We Go?" *FITUES
Ariana Grande "Thank U, Next"
Khalid "Free Spirit"
Post Malone "Hollywood's Bleeding"
Taylor Swift "Lover"




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Robin Krasniqi ëndërron të boksojë në stadiumin 'Fadil Vokrri'

Robin Haxhi Krasniqi ka thënë në Prishtinë se titullin botëror në boks ua dedikon të gjithë shqiptarëve kudo që janë. Ai në një konferencë për gazetarë është i kënaqur që ka arritur ta bëjë Kosovën krenare. Krasniqi ka thënë se fitimi i titullit botëror në boks është fillim drejt sukseseve të tjera në karrierën e tij prej boksieri. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ëndërron të boksojë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë



Prishtinë, 15 tetor - Kampioni botëror në boks, Robin Haxhi Krasniqi, ka folur të enjten para gazetarëve në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Ai në cilësinë e kampionit të IBO dhe WBA në kategorinë gjysmë të mesme, ka thënë se këtë titull ia ka dedikuar kombit shqiptar.

"Përshëndetje Kosovë! Përshëndetje Shqipëri, Gjermani, kudo që ka shqiptarë. Ju përgëzoj për fitoren. Është fitore e përbashkët. E di se secili u gëzua si për anëtarë të familjes. Është kënaqësi e imja kur trojet shqiptare sidomos Kosovën e kam nderuar me këto tituj. E falënderoj secilin nga shqiptarët pasi kudo që isha, ata ishin aty. Të tjerët përmes mediave dhe mesazheve. Kështu që, faleminderit të gjithëve! Faleminderit shumë!", ka thënë Krasniqi, duke numëruar peripecitë që ka kaluar gjatë këtyre viteve si boksier profesionist.

"Normalisht ka qenë vështirësi e madhe. Jam integruar atje dhe boksoj për Gjermaninë, por gjithmonë e kam cekur vendim tim me krenari të madhe. I kam përcaktuar dy vendet. Atje duhet punuar 10 herë më shumë për të mposhtur një gjerman. Ishte më e vështirë ndaj gjermanëve. Zhvillimet ishin pjesë e suksesit. Nuk bën të rrish aty ku je, duhet vazhduar përpara. Ishte ëndërr e imja ta realizoja këtë ditë. Ato mediat atje kanë parë favorit kundërshtarin tim dhe donin ai të ishte fitues, por historia ime, normalisht si 17-vjeçar që isha atje, suksesi vonoi 15 vjet dhe ishte prekëse edhe për ata. Pas ndeshjes edhe ata janë kthyer në favorin tim dhe kanë shumë respekt", është shprehur ai.

Më tutje, ai ka treguar se di e ka mposhtur gjermanin Dominic Boeselin në garën për të parin e botës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se shpreson që në të ardhmen të boksojë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. "Po ky grusht ka qenë grusht i 15 vjetëve. Përvojë, sakrificë, i gjithë agresiviteti i këtyre viteve, sfidave ishin në atë grusht. Salla nuk ishte aq e zbrazur. Kishim 2500 shikues. Më së paku gjysma ishin prej shqiptarëve. Kur ishin gjysma, dukej sikur të ishte e gjitha me shqiptarë, pasi shqiptarët mposhtin gjermanët me brohoritma. Nuk mund ta përjetoj më kurrë atë gëzim. Shpresoj të kemi mundësi të festojmë prapë, kur të më jepet rasti. Është ëndërr e madhe të boksoj në stadiumin 'Fadil Vokrri', në vendin tim ku besoj është adrenalinë tjetër. Unë kam kontratë të boksoj kundër Boeselit. Së pari besoj se duhen deri në 6 muaj për të qenë komplet i shëruar i vetëdijshëm dhe i stërvitur, çdo gjë që na bën të sigurt. Jam i pajtimit ta respektoj kontratën dhe ta mbroj titullin. Është e vështirë, por besoj i takoj vendit ku marrë me qejf përgjegjësitë e mëdha" është shprehur Krasniqi, duke falënderuar mediat për përkrahjen.

"Falënderoj mediat sepse gjatë gjithë karrierës pashë mesazhe pozitive. Faleminderit shumë. Ju them se në orën 14:00 dërgoj titujt në Prekaz, te varrezat e Jasharëve. Nga aty kemi lirinë dhe kur shkoj në atë vend unë ndihem i vogël. Jam krenar që sot bëj një shenjë për këtë vend. Gjithmonë respekt dhe atij vendi i përkulemi gjithmonë", ka thënë Robin Krasniqi.

Më 10 tetor në Magdeburg të Gjermanisë, Robin Haxhi Krasniqi ka nokautuar Dominic Boeselin në raundin e tretë, duke fituar titullin e përkohshëm të botës në versionin WBA, në kategorinë gjysmë të rëndë. Po ashtu, ai ka fituar titullin e botës në versionin IBO, që nuk është në mesin e katër versioneve të forta të boksit profesionist, por vjen menjëherë pas tyre.

# Kosova kthehet me një pikë nga Greqia



Athinë, 15 tetor - Përfaqësuesja e Kosovës në Futboll ka regjistruar ndeshjen e shtatë radhazi pa fitore, duke marrë barazimin e dytë në Ligën e Kombeve krahas edhe pesë humbjeve të pësuara nga ndeshjet e kaluara. Në ndeshjen e vlefshme për raundin e katërt në kuadër të grupit të tretë në Ligën C, "dardanët" të mërkurën mbrëma kanë arritur të marrin një pikë nga udhëtimi te Greqia. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin olimpik "Spyros Louis" të Athinës ka përfunduar pa gola, pavarësisht rasteve të mira për të shënuar që kishin të dyja skuadrat. Momenti kyç i ndeshjes ishte minuta e 19-të kur portieri Arijanet Murici ka pritur penalltinë e ekzekutuar nga Anastasios Bakasetasit. Ndryshe, Greqia tani ka 8 pikë dhe renditet në pozitën e dytë në grup, pas Sllovenisë, kurse Kosova renditet në pozitën e tretë me 2 pikë. Pjesë e këtij grupi është edhe Moldavia, e cila ka vetëm një pikë.

# 'Dua të jem Vedat Muriqi i Lazios, jo Ibra i Lazios – i lumtur që do të luaj me Immobilen'

Vedat Muriqi bëri një tjetër hap të madh në karrierë këtë verën pasi u transferua nga turqit e Fenerbahces në kampionatin italian te Lazio, për shifrën e 20 milionë eurove, ndërsa sot bëri edhe prezantimin zyrtar.

Në daljen për mediat sulmuesi nga Prizreni foli me superlativa për Lazion dhe shokun e tij të ri të repartit Ciro Immobilen, ndërsa theksoi se mezi pret të luajë derbin ndaj Romës dhe të ndihmojë bardhekaltrit të marrin suksesin.

**Transferimi te Lazio** – Jam një nga klubet më të rëndësishme në Itali, në klubin kryesor të kryeqytetit dhe dua të jem po aq i madh sa edhe Lazio. Jam shumë i lumtur për transferimin këtu.

**Derbi ndaj Romës** – Të gjithë futbollistët do të donin të luanin. Është një ndeshje e jashtëzakonshme dhe mezi pres ta përjetoj në fushë.

**Immobile** – Është një ëndërr të luash me të dhe të veshësh të njëjtën fanellë me të. E di që mund të mësoj shumë nga një sulmues si ai dhe do të bëj të pamundurën që ta ndihmoj të shënojë sa më shumë gola.

Ibra i Lazios – Dua të jem Vedat Muriqi i Lazios. Do të bëj maksimumin për këtë fanellë, për trajnerin, shokët e skuadrës dhe gjithë tifozërinë.



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpall:**

## K O N K U R S

**Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

**Përbërja e Këshillit**

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

**Funksionet e Këshillit :**

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
- Mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.

**Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

**Mandati i anëtarëve të Këshillit**

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:**

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

**PROCEDURA E KONKURIMIT**

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 04.11.2020, në orën 16:00.**
Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

**Aplikacionet mund të merren në këto vende**:

*Forma e shtypur*: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
*Forma elektronike*: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshë

m dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**
**Kuvendi – Skupština – Assembly**

**Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova raspisuje**

## K O N K U R S

**Za izbor dva (2) člana Nezavisnog nadzornog odbora za Civilnu službu Kosova, iz ne albanske zajednice**

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

**Sastav Odbora**

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova.
Od toga,najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

**Funkcije Odbora:**

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa,odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

**Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:**

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje 10 (deset ) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje 5 (pet) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljavanja iz civilne službe.

**Mandat članova Odbora**

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju,da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

**Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta**

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- CurriculumVitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

**PROCEDURA KONKURISANJA**

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 04.11.2020. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza" bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

**Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:**

*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul."Majka Tereza" bb. ili u
*Elektronskom obliku:* internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

## Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:**

## K O N K U R S

**Për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Në bazë të Ligjit nr.05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Komisioni për Ndihmë Shtetërore është përgjegjës për këto detyra dhe përgjegjësi:

- vendos për autorizimin e ndihmës shtetërore;
- ofron komente me shkrim për projektligjet të cilat organet propozuese vlerësojnë se projektligjet kanë elemente të ndihmës shtetërore;
- vendos për përputhshmërinë e ndihmës shtetërore;
- urdhëron revokimin e ndihmës, në rast se vlerësohet se ndihma shtetërore nuk është në pajtim me dispozitat në fuqi për ndihmën shtetërore;
- propozon masa adekuate për të siguruar që çfarëdo skeme ekzistuese e ndihmës të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- autorizon përputhshmëritë e kushtëzuara të ndihmës shtetërore;
- Komisioni miraton Rregulloren e Punës, ku përcaktohet organizimi, procedurat administrative të vendimmarrjes si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit;
- Komisioni, çdo vit deri më 30 shtator miraton Raportin Vjetor të Ndihmës Shtetërore dhe ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Komisioni ushtron detyrat dhe përgjegjësitë tjera, të përcaktuara me Ligjin për Ndihmë Shtetërore.

**Mandati i anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, emërohen me mandat tri (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, nuk duhet të mbajnë funksione publike dhe pozita të emëruara politike.

**Kandidatët për anëtarë të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, duhet të plotësojnë kushtet si vijon:**

- të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- të jenë të diplomuar në fakultetin ekonomik apo juridik, apo në fushat tjera përkatëse që lidhen me fushën e ndihmës shtetërore;
- të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale fushat e drejtësisë, financave publike ose fushat tjera që ndërlidhen me ndihmën shtetërore;
- të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burg për më shumë se gjashtë (6 muaj);
- të kenë aftësi për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me vendoshmëri dhe përgjegjshmëri.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:**

- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- CV;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

**PROCEDURA E KONKURIMIT**

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 30.10.2020, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);
*Me e-mail:* *personeli.krk@assembly-kosova.org*

**Aplikacionet mund të merren në këto vende**:

*Forma e shtypur***:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
*Forma elektronike***:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës *www.assembly-kosova.org*

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

## Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Skupština Republike Kosovo raspisuje:**

## K O N K U R S

**O izboru dva (2) člana Komisije za državnu pomoć**

Shodno Zakonu br.05/L-100 o državnoj pomoći, članovi Komisije za državnu pomoć, imenuju se od Skupštine Republike Kosovo.

**Dužnosti i odgovornosti Komisije za državnu pomoć**

Komisija za državnu pomoć odgovorna je za sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Odlučuje o ovlašćenju državne pomoći;
- Pruža pismene komentare na Nacrte zakona koje organi predlagači smatranju da isti imaju elemente državne pomoći;
- Odlučuje o usklađenosti državne pomoći;
- Naređuje ukidanje pomoći u slučaju ako se proceni da državna pomoć nije u skladu sa odredbama na snazi o državnoj pomoći;
- Predlaže adekvatne mere kako bi se obezbedilo da bilo koja postojeća šema pomoći bude u saglasnosti sa odredbama ovog zakona;
- Ovlašćuje uslovljene usklađenosti državne pomoći;
- Komisija usvaja Poslovnik, gde se određuje organizacija, upravni postupci odlučivanja kao i prikladne mere za izbegavanje sukoba interesa;
- Komisija, svake godine do 30. septembra usvaja godišnji izveštaj državne pomoći i isti prosleđuje Skupštini Republike Kosovo;
- Komisija vrši ostale dužnosti i obaveze određene Zakonom o državnoj pomoći.

**Mandat članova Komisije za državnu pomoć**

Članovi Komisije za državnu pomoć, imenuju se sa mandatom od tri (3) godine, sa mogućnošću ponovnog izbora za još jedan mandat. Članovi komisije za državnu pomoć, ne smeju držati javne funkcije niti političko imenovane pozicije.

**Kandidati za članove komisije za državnu pomoć, trebaju ispuniti sledeće uslove:**

- Da su državljanin Republike Kosovo;
- Da su diplomirali na ekonomskom ili pravnom fakultetu, ili ostalim relevantnim oblastima koje se nadovezuju sa oblašću državne pomoći;
- Da imaju najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblastima pravosuđa, javnim finansijama ili ostalim oblastima koje se nadovezuju sa državnom pomoći;
- Da nisu pravosnažno osuđeni na kaznu zatvora više od šest (6) meseci;
- Da imaju sposobnosti za vršenje dužnosti nepristrano, svesno, odlučno i odgovorno.

**Priloženo aplikaciji trebaju biti i sledeći dokumenti:**

- Dokaz državljanstva Republike Kosovo;
- Dokaz školske i stručne pripreme;
- Motivaciono pismo;
- CV- Biografija;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nisu osuđeni za krivično delo.

**PROCEDURA KONKURISANJA**

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 30.10.2020. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza" bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

*E-mailom:* *personeli.krk@assembly-kosova.org*

**Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:**

*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul."Majka Tereza" bb. ili u
*Elektronskom obliku:* internet–stranica Skupštine Republike Kosova - *www.assembly-kosova.org*

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana *u 16:00 časova, na brojeve telefona:* 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Namik Rexhepi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Xhelal Thaqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Luan Elezkurtaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Emine Geshtenja shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Albana Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

▶ Munever Qafleshi shpall te pavlefshme 3 dëftesat, certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Shenoll Temo shpall te pavlefshme 2 dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përballë "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L